

DRC KOSOVË – KORNIZA E PËRGJEGJSHMËRISË HUMANITARE

30 SHTATOR 2009

Në DRC ne dëshirojmë të jemi të përgjegjshëm. Jo vetëm për donatorët dhe anëtarësinë tonë, por – çka është më e rëndësishme, për ata të cilët përpiqemi t'i ndihmojmë. Ne kemi shumë instrumente për këtë, siç janë, pjesëmarrja, komentet, marrja e ankesave dhe raportimi. Një element i rëndësishëm është informimi i përfutuesve tanë dhe subjekteve mbi Kornizën tonë të Përgjegjshmërisë Humanitare që qartë definon se për çka ata mund të na mbajnë të përgjegjshëm.

1) Përshkrim i shkurtër i Programit Regjional mbi zyrën në terren/shtet nëse ka ndonjë të tillë

Programi aktual i asistencës i DRC në Ballkanin Perëndimor është ngritur nga intervenimet gjithëpërfshirëse të DRC në konflikte dhe zhvendosje të cilat pasuan pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë gjatë viteve 1990. DRC ishte përgjegjëse për një varg të gjerë programesh duke filluar nga ndihma emergjente lehtësuese deri të rehabilitimi dhe rindërtimi afat-gjatë.

Sot, DRC është prezente përmes tri zyreve të saj kryesore në Beograd, Prishtinë dhe Sarajevë, dhe gjithashtu ka zyrat e saj në terren dhe ato satelite në Mal të Zi dhe Maqedoni. Programet e DRC janë të orientuara kah komuniteti dhe integrojnë sektorë të ndryshëm të cilat mbështesin si komunitetet nikoqire ashtu edhe refugjatët, PPZH dhe të kthyerit.

DRC andaj ka përparësi krahasuese kur vie fjala te përvoja në regjion, aftësitë regjionale, dhe qasja shumë-sektoriale ndaj çështjeve të zhvendosjes dhe kthimit.

Vizioni afatgjatë i gjithëmbarshtëm i DRC për Ballkanin Perëndimor është të promovoj paqen dhe stabilitetin përmes zgjidhjeve të qëndrueshme për refugjatët dhe PPZH.

2) Objektivat, Partnerët dhe Subjektet e DRC në fushën e veprimit

Objektivat:

Objektivat e gjithëmbarshtme programatike përkritazi me DRC Kosovë janë:

- Të drejtat themelore të atyre të cilët janë të zhvendosur dhe të paaftë për të kërkuar zgjidhje të qëndrueshme, apo janë të pasigurtë në procesin e tyre vendim-marrës, janë të mbrojtur dhe të vetëdijshëm mbi opsionet e tyre për të kërkuar zgjidhje të qëndrueshme.
- Njerëzit, të cilët kanë zgjedhur zgjidhje të qëndrueshme (kthimin/vendosjen lokale dhe/ose rivendosjen lokale), po lëvizin drejt drejt (re-) integritit të qëndrueshëm duke u bazuar në kapacitetet dhe burimet e tyre vetanake.
- Politikat lokale dhe kapacitetet angazhohen në mbrojtjen e të drejtave të njerëzve për të kërkuar zgjidhje të preferuar të qëndrueshme dhe kontribuojnë pozitivisht në lehtësimin e proceseve (re-) integruese.


Subjektet & Partnerët

Në Kosovë, DRC punon me subjektet dhe partnerët vijues:

- Institucionet Qendrore dhe Autoritetet Lokale, përfshirë Ministrinë dhe Komunitetet në tërë Kosovën
- Zyren Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë
- UNHCR
- UNDP
- Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit të Kosovës
- Komunitetin Donator
- UNMIK-un Zyren për Përkrahjen dhe Ndihmën Komuniteteve
- OSCE
- KFOR
- Policinë Ndërkombëtare/Policinë e Kosovës
- Agjencinë Kosovare për Prona
- OJQ të lokale në Kosovë dhe Serbi

- DRC-Kosovë është anëtar ekzekutiv i Grupit Koordinues të OJQve për Paqe-ndërtim (NPCG),
- Partneritetin për Paqe – DRC është në Bordin Këshillues të rrjetit të OJQL të Partneritetit për Paqe.

3) Organigrami i DRC Kosovë përfshirë edhe Funkcionet e Linjës së Stafit



4) Standardet dhe Kodet Lokale dhe Ndërkombëtare

DRC është OJQ ndërkombëtare e regjistruar në mënyrë të duhur që punon në Kosovë dhe të cilit i është lëshuar certifikata e regjistrimit nga UNMIK-u – Rregullorja 1999/22 mbi Regjistrimin dhe Veprimin. DRC i përmbahet standardeve ndërkombëtare gjatë programimit dhe implementimit. Si i tillë, Standardet Sferike janë pjesë integrale e Doracakut Programatik të DRC që udhëzon programimin global dhe lokal. DRC aderohet plotësisht kah parimet e parapara të ICRC në Kodin e Mirësjelljes.

DRC gjithashtu ka zhvilluar doracakun e politikës së zyrës & stafit dhe mekanizmi ankimor i stafit do të bëhet pjesë përbërëse e tij. Si shtesë kësaj, DRC ka themeluar skemën shkallëzore të pagave për stafin vendor.

DRC siguron që intervenimet të përmbahen parimeve dhe dispozitave të ligjit ndërkombëtar humanitar, ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, Parimeve Udhëzuese mbi Zhvendosjen e Brendshme, si dhe atyre standardeve Sferike që janë relevante për aktivitetet individuale.

5) Pjesëmarrja e Përfituesve

Duke qenë OJQ HAP e certifikuar që implementon Përgjegjshmërinë Humanitare në programet e tij, pjesëmarrja dhe komentet e përfituesve përmes mekanizmit të krijuar që merret me ankesa në programet e DRC është një komponentë kyçe dhe mbetet gur-themel i punës së DRC.

Aktualisht, DRC po organizon trajnim për stafin e tij në terren dhe për partnerët e projektit për të pasur një njohuri më mirë dhe dijeni mbi HAP si dhe të përafrohen me mjetet përkitazi me aplikimin e HAP në praktikë.

Përfituesit e pretenduar janë zgjedhur përmes procedurave dhe kritereve të duhura dhe të njëjtit janë identifikuar duke iu referuar përfaqësuesve të tyre, gjithashtu gjinisë dhe moshës, pa-aftësisë dhe brishtësive tjera identifikuese.

DRC siguron që përfituesit të marrin pjesë në disajnimin e projektit, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin përgjatë tërë ciklit të projektit. Pjesëmarrja e përfituesve arrihet përmes mbledhjeve të komunitetit, intervistave, vlerësimeve dhe qasjes pjesëmarrëse. Përveç kësaj, përfituesit japin pajtimin e tyre kur të vie të vendim-marrja mbi veprimtarinë e programit.

Si plotësim, DRC dëshiron të promovon komentet e përfituesve në strategjinë vepruese të gjithëmbarshme të shtetit për të siguruar që dokumentet e programit marrin qasjen nga poshtë – lart.

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave

Do të ketë situata kur disa përfitues apo përfitues potencial nuk do të pajtohen me vendimet e marra në lidhje me familjet e tyre apo rolin e komunitetit brenda projektit të DRC. Ekziston një mekanizëm efektiv dhe i qasshëm për ankesat e përfituesve për të siguruar se përfituesit mund të mbajnë DRC të përgjegjshëm për vendimet e marra gjatë implementimit të projektit. Aktualisht ky mekanizëm vepron në baza *ad hoc*, ku përfituesit që kanë parashtruar ankesë me shkrim do të marrin një përgjigje me shkrim nga DRC. Ky mekanizëm aktualisht është në shqyrtim dhe formalisht do të zhvillohet në pajtim me doracakun e DRC mbi ankesat e përfituesve. Paralelisht me këtë shqyrtim, DRC po organizon trajnime të brendshme për stafin e tij të projektit, për përdorimin e tij në punën e përditshme.

6) Lista e Projekteve, Objektivave, Përfituesve, Autoriteteve Relevante, Finansimit dhe Partnerëve Implementues –

Titulli i Projektit	Ofrimi i Informatave dhe Lehtësimit i Kthimit të Minoriteteve në Kosovë
Lëmia e fokusit	Programi i kthimit, Kalimi kufitar/zona kufitare (Regjionale)
Donatori:	BPRM
Objektivi:	Qëllimi i gjithëmbarshtëm i projektit është të promovohet paqa dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor përmes promovimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për refugjatët dhe PZH /PPZH në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi
Përfituesit:	PPZH /Refugjatët
Autoritetet e përfshira:	Komunat në Kosovë, UNMIK, UNHCR, OSCE, Policia e Kosovës, KFOR etj.
Partnerët implementues:	n/a

Titulli i Projektit	Kthimi dhe Re-integrimi në Kosovë – RRK II
Lëmia e fokusit	Ndihma e Kthimit të Minoriteve përmes Aktiviteteve të Ndërtimit të Kapaciteteve
Donatori:	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete
Objektivi:	Objektivi i gjithëmbarshtëm i projektit është të kontribuoj për një shoqëri stabile multi-etnike në Kosovë, të bazuar në tolerancë t dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve që mundëson kthimin e qëndrueshëm dhe re-integrimin e së paku 210 PPZH minoritar në Kosovë gjatë periudhës 24 mujore implementuese.
Përfituesit:	PPZH/Refugjatët, Akterët Shtetëror dhe Jo-Shtetëror
Autoritetet e përfshira:	Ministria për Kthim dhe Komunitete, Komunat në Kosovë, UNMIK, UNHCR, OSCE, Policia e Kosovës, KFOR etj.
Partnerët implementues:	OJQ lokale: Syri i Vizionit, Komunat e Projektit

Titulli i Projektit	Përkrahja kthimit të qëndrueshëm të grupit specifik shënjestër të azil-kërkuesve të refuzuar nga Danimarka në Kosovë
Lëmia e fokusit	Re-integrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i të kthyerve nga Danimarka

Donatori:	Ministria e Punëve të Jashtme Daneze - ENR
Objektivi:	Objektivi i gjithëmbarshtëm i projektit është që azil-kërkuesit e refuzuar nga Kosova që qëndrojnë aktualisht në Danimarkë të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë.
Përfituesit:	Deri në 15 të kthyer nga Danimarka
Autoritetet e përfshira:	Autoritetet Qendrore dhe Komunale të Kosovës
Partnerët implementues:	Qendra Rehabilituese për Viktimat e Torturës e Kosovës - KRCT

Titulli i Projektit	Stabilizimi Ekonomik dhe i Komunitetit të Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve (RAE) në Lagjen e Romëve, Mitrovicë, Kosovë
Lëmia e fokusit	Fuqizimi i kapaciteteve të komunitetit RAE përmes zhvillimeve intensive ekonomike, të komunitetit dhe shoqërisë civile me komponentet e qeverisjes së mirë.
Donatori:	Irish Aid, Departamenti i Punëve të Jashtme
Objektivi:	Të kontribuoj në stabilizimin e Kosovës multi-etnike duke forcuar stabilizimin social dhe ekonomik të Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve në Lagjen e Romëve, Mitrovicë
Përfituesit:	Të kthyerit nga komuniteti i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve në Lagjen e Romëve, Mitrovicë
Autoritetet e përfshira:	Autoritetet Komunale, UNMIK, BE Zyra Civile Ndërkombëtare, OSCE
Partnerët implementues:	Norma, Mundësia, RWRW, GG2Korriku, Shëndeti-Kos, Caritas-Kosova

Titulli i Projektit	Mbështetja logjistike për shpërndarjen e asistencës humanitare në Kosovë – përkrahja për PPZH nga Kosova
Lëmia e fokusit	Informatat mbi kalimin kufitar/zonën kufitare dhe programi jashtë-arritës (Regjional)
Donatori:	UNHCR
Objektivi:	Qëllimi i gjithëmbarshtëm i projektit është të promovohet paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor përmes promovimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për refugjatët, PZH, PPZH në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi; Mbështetja logjistike për UNHCR (shpërndarja, mirëmbajtja e depove, automjeteve, kamionëve, gjeneratorëve dhe pajisjeve tjera)
Përfituesit:	PPZH/ Refugjatët
Autoritetet e përfshira:	Komunat në Kosovë, UNMIK, UNHCR, OSCE, Policia e Kosovës, KFOR etj.
Partnerët implementues:	n/a

7) Plani për Përmirësimin e Përgjegjshmërisë 2009 -2010

Pika e Veprimit	Përmirësimi	Monitorimi
Stafi i terrenit i DRC dhe partnerët e tij implementues kanë njohuri më të mira dhe janë të trajnuar mbi standardet e HAP dhe kushtet e tij, procedurat dhe normat.	Program trajnues për të përfshirë tërë stafin në terren mbi të gjitha nivelet e mundshme përfshirë punëtoritë dhe partnerët implementues OJQ	Vlerësimet trajnuese dhe planet përcjellëse duhet të bëhen. Të gjitha Marrëveshjet e Partneritetit me Partnerët Implementues të përfshijnë klauzolën HAP.
Agjencia do të themelojë një proces të përmirësimit të vazhdueshëm për HAF të tij dhe stafi përdor HAF-in dhe sistemin e menaxhmentit kualitativ.	Program gjithëpërfshirës trajnues. HAF azhurnohet rregullisht dhe është në dispozicion gjithashtu në	Dokumenti i azhurnuar HAF është në dispozicion në ueb faqen e DRC dhe për përfituesit e tij.

	gjuhën Shqipe dhe Serbe për përfituesit e tij, donatërit dhe subjektet tjera relevante.	
DRC ka zhvilluar mjete për të siguruar që sistemi i menaxhmentit kualitiv humanitar është në vend. MEP janë bërë për të gjitha projektet dhe projektet angazhojnë një vlerësues të jashtëm për të bërë kontrollimin e kualitetit.	DRC do të siguroj që MEP janë të azhurnuara për të gjitha projektet (në vijim). Raportet e jashtme vlerësuese do të shqyrtohen me ekipin e projektit dhe donatorët (në vijim).	Monitorimi i Selisë dhe shqyrtimet vjetore programatike sipas doracakut të programit.
DRC përdor qasjen pjesëmarrëse në programin e tij përgjatë planifikimit të projektit, disajnit dhe periudhës implementuese dhe kërkon pajtimin e informuar të përfituesve.	DRC do të siguroj që për të gjitha projektet përfituesit janë plotësisht të integruar në procesin e vendim-marrjes (në vijim) dhe janë të aftë për të kontribuar në strategjinë shtetërore të DRC.	Përfituesit e projektit do të jenë të përfshirë në vlerësimin e projektit dhe do të zhvillohet forma e pjesëmarrjes
Kompetencat dhe aftësitë e stafit në terren janë forcuar dhe nevojat zhvillimore janë identifikuar dhe adresuar.	Sistemi i vlerësimit të stafit identifikon nevojat zhvillimore të stafit (në vijim) Programi trajnues për stafin.	Monitorimi i Selisë të lëmisë strategjike fokusuese të HRD sipas doracakut të programit.
Mekanizmat e ankesave të përfituesve janë përforcuar dhe bëhen pjesë përbërëse e të gjitha projekteve. Trajnimet e organizuara për tërë stafin.	Implementimi i mekanizmit formal ankimor të përfituesve është bërë në vitin 2009.	Mbajtja e regjistrave të ankesave të përfituesve dhe dokumentimi i përgjigjeve të DRC.
Mekanizmi ankimor i stafit bëhet sistem operativ i qasshëm, i sigurt dhe efektiv për zgjidhje të shpejtë.	Implementimi i mekanizmit ankimor të stafit në terren bëhet kah fundi i vitit 2009.	Mbajtja e regjistrave të ankesave të stafit dhe dokumentimi i përgjigjeve të DRC.